



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 384/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 11.12.2010, mori këtë:

### **V E N D I M**

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 4400 (katërmijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Lëvizja Vetëvendosje, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se PDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3.1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se me 08 dhjetor 2010 në orën 19:15 në rrugën Luan Haradinaj në Prishtinë gjatë fushatës zgjedhore nga anëtarët e subjektit politik të PDK-së është bërë mbulimi i posterave të lëvizjes Vetëvendosje me ate të kandidatës të PDK-së Mrika Tahiri, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (b) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3.1 pika (b), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë posterat e kandidatës të PDK-së mbi atë të Lëvizjes Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 09.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.12.2010, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i vlerëson se PDK, shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, andaj konsiderohet si recidivist e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 384/2010 më datën 11.12.2010

